



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Mars 2019

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prij

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nentor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2019

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2019
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Mars 2019 arriti në 107.9 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin Mars 2019 ishte 1.1 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Mars 2019 ishte 110.53 lekë për dollarë dhe 124.99 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Mars 2019 shënuan kuotën 0.57 për qind për ato 12 –mujore; 0.56 për qind për depozitat 6-mujore; 0.31 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.55 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 5.89 për qind për huatë 12-mujore dhe 7.69 për qind për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në rreth 1.277.620 milionë lekë në muajin Mars, duke shënuar një rritje prej rreth 3.2 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e katërt të 2018-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 274.0 milionë euro.
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Mars 2019 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 3.5 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar 2.2 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar- Mars 2019, arritën në rreth 108.088 miliardë lekë ose afërsisht 99% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 104.543 miliardë lekë ose 97% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Mars 2019 ishte +1.1%. Ndërsa, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +2.0%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Mars 2019 shënoi rënie prej 0.3 për qind krahasuar me muajin paraardhës, ndërsa në muajin Shkurt 2019 pati rritje prej 0.6 për qind. Edhe përgjatë muajit Janar 2019, indeksi ka shënuar rritje prej 1.6 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Mars 2018 shënoi rritje prej 0.3 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Mars 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2.0%, pasuar nga grupet “Hotele, kafene dhe restorante” me 1.2%, “Argëtim dhe kulturë” me 1.1%, duke vijuar me “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1.0% secila, “Shërbimi arsimor” me 0.7%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0.5%, etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria “Shëndeti” ka ndikuar negativisht në inflacionin



e përgjithshëm përgjatë muajit Mars 2019, përkatësisht me -0.4%

Ndryshimi mujor i indeksit është -0.3%. Krahasuar me muajin Shkurt 2019, çmimet e grupit “Transporti” u rritën me 0.5%, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0.2 %, “Pije alkoolike dhe duhan”, “Shëndeti”, “Argëtim dhe kulturë” me 0.1% përkatësisht etj. Ndërsa, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije alkoolike” ranë me -0.8%, “Veshje dhe këpucë” me -0.6% dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me -0.2%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2018	1.7	2.1	2.0	2.1	2.1	2.4	2.3	2.2	2.1	1.9	1.8	1.8
2019	1.9	1.7	1.1									


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Mars 2019, arriti në 124.99 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.34 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Mars, një euro u këmbye me 125.34 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Mars 2019 arriti në 110.53 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.74 për qind kundrejt muajit Shkurt 2019. Në fund të muajit Mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 111.67 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Mars të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 4.81 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 3.83 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.88 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Mars 2019, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 6 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.57 dhe 0.56 për qind, pasuar nga ato me afat 1 dhe 3 mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.55 dhe 0.31 për qind.

Normat e interesit të depozitave 6 dhe 3 mujore kanë shënuar rritje mujore prej përkatësisht 0.11 dhe 0.06 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 1 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie me 0.16 dhe 0.11 pikë përqindje përkatësisht.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 3 dhe 6 mujore, kanë shënuar rritje prej përkatësisht 0.04 dhe 0.01 pikë përqindje, ndërsa ato me afat maturimi 12 dhe 1 mujore kanë pësuar rënie vjetore me 0.46 dhe 0.38 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Mars 2019 arritën përkatësisht kuotën prej 7.69 dhe 5.89 për qind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.19 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit 12 mujore nuk kanë pasur ndryshim. Duke krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 12 dhe 6 mujore kanë pësuar rënie përkatësisht me 0.95 dhe 0.32 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Mars 2019 arritën nivelin 1.14 për qind duke shënuar kështu rënie mujore prej 0.11 për qind dhe rënie vjetore prej 1.37 për qind.

Fig. 3





Fig-4





4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2018 shënoi rritje të mjeteve valutore, me rreth 274 milionë euro. Tremujori i katërt i 2018-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 363.5 milionë euro, dhe vlerësohet në terma vjetore (rreth 17%). Deficiti tregtar u zgjerua me rreth 8%, në nivelin 616 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 322 milionë euro në rritje me 55 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset hyrëse në *llogarinë kapitale dhe financiare* (pa përfshirë mjetet e rezervës), vlerësohen në rritje për periudhën dhe mbulojnë plotësisht deficitin korrent. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 3.004 milionë euro dhe janë zgjeruar me 6% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 363.5 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 17%. Ecuria e deficitit korrent në këtë tremujor, reflekton zgjerimin e deficitit tregtar të mallrave dhe njëkohësisht ngushtimin e suficitit të të ardhurave dyrësore, si pasojë e rënies së granteve qeveritare në formën e asistencës teknike. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e tretë 2018 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -831.1 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 214.7 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 14.6 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 283.3 milionë euro.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Mars 2019, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 48.189 milionë lekë krahasuar me muajin Mars të vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto bankës qendrore me rreth 51.031 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 4.059 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 10.460 milionë lekë e bankave paradepozituese.

Fig-7




Ecuria e M.V.N. të sistemit në Mars '18 - Mars '19

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1.277.621 milionë lekë në muajin Mars 2019, duke shënuar rritje prej rreth 39.198 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.2 për qind.

Në muajin Mars 2019, sistemi bankar rezulton me rënie prej 962 milionë lekë ose -0.1 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.

Fig-8




Agregati M3 Mars '18 - Mars '19


Burimi: Banka e Shqipërisë

6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Mars 2019 arriti në rreth 547.183 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rënie me vlerë 1.001 milionë lekë, ose rënie prej rreth 0.18 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (49.8%) dhe monedhave të huaja (50.2%).



Gjatë muajit Mars 2019, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 59.8 për qind ose 326.948 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.19 për qind ose 187.060 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.91 dhe 2.03 për qind apo 21.417 dhe 11.102 milionë lekë.




Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Mars 2019, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.1 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.1 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me rreth 2.1 për qind dhe rreth 1.7 për qind.

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 274.739 milionë lekë në fund të muajit Mars 2019. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Mars 2019 ka shënuar rritje mujore prej 0.17 për qind si dhe rritje vjetore prej 0.96 për qind, duke arritur nivelin 21.5 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.28 për qind dhe rritje vjetore prej 1.54 për qind, duke shënuar nivelin 27.4 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Mars 2019, kanë pësuar rritje prej 18.868 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.7 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa depozitat në Lekë gjatë muajit Mars 2019 shënuan rritje prej 29.6 milionë lekë në krahasim me muajin Mars 2018. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.8 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Mars 2019, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.8 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.9 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.7 për qind dhe rreth 16.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 82.2 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 823.983 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (146.632 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (15.247 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (15.417 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.600 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Mars 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Mars 2019, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.002.882 miliardë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave pësoi rënie prej rreth 2.938 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 18.899 milionë lekë.


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Mars 2019 janë mbledhur rreth 108.088 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 104.543 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 95.326 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 9.199 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 34% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 72.773 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 4.909 miliardë lekë (ose rreth 135% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 23.588 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 5.876 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit për periudhën Janar-Mars 2019).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 95.344 miliardë lekë, 18.305 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 9.525 miliardë



lekë (10%) për shpenzime interesi, 9.028 miliardë leke (9%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 359 milionë lekë (0.4%) për subvencione, 40.017 miliardë lekë (42%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 12.669 miliardë lekë (13.2%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 5.441 miliardë lekë (5.7%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 23% (shpenzime personeli), 23% (shpenzime për interesat), 19% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 24% (subvencione), 22% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 25% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 23% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 11%, ndërsa financimi i huaj është 9% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Mars 2019 ishin rreth 108.088 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 101.552 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 5.876 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë muajit Mars 2019 (mld Lekë)
Revenues during March 2019 (in billion ALL)

Burimi (Source)	Mars '19 March '19	Mars '18 March '18	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	10.8	11.7	-7.5
Taksa doganore (Custom Tax)	0.5	0.5	9.2
Akcizat (Excise)	3.8	3.4	11.8
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	7.6	6.1	24.0
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	2.7	2.5	9.9
Taksat nacionale (National Tax)	2.0	2.4	-16.1

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Mars – 2019

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: March – 2019

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 3.545 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Mars 2019, u përdor kryesisht për huamarrjen e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe për huanë afatgjatë të huaj.

Për muajin Mars 2019, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 39.373 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 37.011 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Mars 2019, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 36.9 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 33.5 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 3.3 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	
Janar	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	January
Shkurt	2.4	1.1	0.5	0.8	0.6	1.9	1.0	1.0	1.0	1.1	2.3	0.2	2.2	2.1	1.7	February
Mars	0.4	0.5	0.4	0.3	-0.3	1.4	0.8	0.8	0.9	0.6	2.2	0.3	2.1	2.0	1.1	March
Prill	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5		0.9	0.5	0.5	0.7		2.3	0.3	1.9	2.1		April
Maj	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2		0.3	0.2	0.1	0.2		1.8	0.7	2.0	2.1		May
Qershor	-1.1	-0.6	-0.4	-0.1		0.1	0.04	0.0	0.1		1.4	1.2	2.2	2.4		June
Korrik	-0.7	0.05	-0.14	-0.27		0.1	0.21	0.0	0.1		1.3	1.9	2.0	2.3		July
Gusht	0.8	0.86	0.41	0.36		0.1	0.22	0.1	0.1		1.9	2.0	1.6	2.2		August
Shtator	0.6	0.40	0.36	0.23		0.2	0.17	0.1	0.1		2.2	1.8	1.6	2.1		September
Tetor	0.01	-0.2	0.0	-0.2		0.2	0.13	0.1	0.1		2.1	1.5	1.9	1.9		October
Nëntor	-0.3	0.1	-0.1	-0.2		0.1	0.12	0.1	0.1		2.1	1.9	1.7	1.8		November
Dhjetor	0.6	0.9	1.0	1.1		0.17	0.19	0.2	0.2		2.0	2.2	1.8	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019			Currency
					Janar	Shkurt	Mars	
					January	February	March	
<i>Mesatarja e periudhës</i>								<i>Average of period</i>
USD	126.64	128.29	112.56	108.43	108.92	109.73	110.53	USD
EURO	137.65	135.27	133.25	123.45	124.39	124.56	124.99	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>								<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.58	110.51	111.67	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	124.64	125.92	125.34	EURO

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2015	2016	2017	2018	2019			In percent
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Norma e depozitave								Deposits rates
12-M	1.27	0.78	0.80	0.75	0.73	0.68	0.57	12-M
6-M	1.17	0.78	0.56	0.56	0.45	0.45	0.56	6-M
3-M	0.54	0.27	0.29	0.30	0.24	0.25	0.31	3-M
1-M	0.88	0.87	0.82	0.62	0.65	0.71	0.55	1-M
Norma e huasë								Lending rates
12-M	7.47	4.54	6.79	6.34	6.76	5.89	5.89	12-M
6-M	8.35	7.01	8.12	8.16	7.63	7.50	7.69	6-M
Norma e letrave me vlerë								Securities rates
Bono thesari 1/								Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	2.46	2.00	-	-	-	1.07	-	6-M
12-M	2.40	2.92	2.63	1.43	1.33	1.25	1.14	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2019

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	34,532	68,709	108,088	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	244	447	659	Grands
II.	Të ardhura tatimore	33,030	64,587	101,552	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	22,638	44,928	72,773	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,971	21,550	32,380	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,613	4,049	11,651	Profit Tax
3	Akcizat	2,900	6,025	9,863	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,677	6,593	9,376	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,068	5,871	8,092	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	410	840	1,411	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,353	3,173	4,909	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	221	431	817	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1	5	27	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,131	2,737	4,066	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	9,038	16,486	23,870	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	7,711	14,064	20,421	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,271	2,213	3,167	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,258	3,675	5,876	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			576	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	712	2,623	3,842	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,422	67,532	104,543	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	28,971	61,789	95,344	Current Expenditures
I.1	Personeli	5,949	12,033	18,305	Personnel expenditures
1	Paga	5,100	10,314	15,679	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	844	1,693	2,570	Social insurance contributions
I.2	Interesat	4,047	6,750	9,525	Interest
1	Të Brendshme	2,846	4,922	6,977	Domestic
2	Të Huaja	1,200	1,828	2,547	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,487	5,479	9,028	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	74	203	359	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	12,387	25,873	40,017	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	9,547	19,193	29,265	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,376	5,890	9,963	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,701	8,096	12,669	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,327	3,354	5,441	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	33	76	130	Unemployment insurance benefits
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	3,451	5,743	9,199	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	2,583	3,237	6,029	Domestically financing
2	Financimi Huaj	863	2,457	3,101	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara				Arrears
V.	DEFICITI	2,110	1,178	3,545	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-2,110	-1,178	-3,545	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-1,502	-2,468	-3,348	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	28	33	46	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-5,900	-7,329	-2,600	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	4,375	4,828	-794	Others
V.3	I huaj	-608	1,291	-197	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,403	2,488	2,919	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	98	130	285	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-684	-343	-164	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	-	1,400	1,400	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2019

Table of investments 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Financim i brendshëm	- 1,502	- 2,468	- 3,348	Domestic financing
<i>Në %</i>	71.2	209.58	94.4	<i>In %</i>
Financim i huaj	- 608	1,291	197	Foreign financing
<i>Në %</i>	28.8	-109.58	5.6	<i>In %</i>
Totali	-2,110	-1,178	-3,546	Total
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2019
CUSTOMS REVENUES 2019**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Taksë doganore	410	840	1,411	Customs Duties
TVSH	6,893	14,742	23,426	V.A.T
Akcizë	2,900	6,025	9,863	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	201	356	532	Others (Mineral Rent)
TOTALI	10,404	21,963	35,232	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2019 (TAX REVENUE)

TVSH	4,079	6,808	8,954	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,613	4,049	11,651	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,677	6,593	9,376	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	2,867	5,515	7,560	National taxes
TOTALI	12,235	22,965	37,541	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	22,639	44,928	72,773	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2019

The Deficit and Its Financing for 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
TË ARDHURAT	34,532	68,709	108,088	REVENUE
SHPENZIMET	32,422	67,532	104,543	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	2,110	1,178	3,545	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-2,110	-1,178	-3,545	FINANCING
Financimi i brendshëm	-1,502	-2,468	-3,348	Domestic
a. Bono Thesari Neto	-1,799	-2,038	-2,192	Treasury bills
b. Obligacione	-4,088	-5,266	-368	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	13,883	14,155	12,003	Chang. of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	13,689	13,289	11,926	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	193	866	77	Deposit of Social & Health Ins.
d. Mjete në ruajtje	418	340	501	Non-budget revenues
e. Të ardhura nga privatizimi	23	33	46	Privatization receipts
f. Të tjera detyrime	-9,926	-9,671	-13,299	Others
g. Huamarrje Brendshme Vendori	-14	-25	-40	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	-608	1,291	-197	Foreign
a. Hua afatgjatë	1,403	2,488	2,919	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-684	-343	-164	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore	0	1,400	1,400	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	3M_I_2018	3M_II_2018	3M_III_2018	3M_IV_2018	
Llogaria korente	-1,303.20	-1,160.50	-1,029.70	-803.10	-171.90	-176.30	-147.50	-363.50	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,136.60	-2,298.80	-2,602.80	-2,823.80	-614.60	-684.30	-740.70	-831.10	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	925.30	771.10	713.70	797.20	218.40	277.80	235.20	254.80	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,061.90	-3,069.90	-3,316.50	-3,621.00	-833.00	-962.10	-975.90	-1,085.90	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	268.40	502.80	796.60	1,082.20	254.60	255.40	379.40	214.70	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,031.50	2,028.20	2,395.70	2,855.90	621.70	744.30	1,003.50	696.30	Services Credit
Shërbimet Debi	1,763.10	1,503.30	1,599.10	1,773.70	367.10	488.90	624.10	481.60	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-159.60	-133.00	-44.10	90.70	-14.70	13.70	-18.90	14.60	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	110.60	126.00	177.10	405.40	72.10	125.40	95.70	104.90	Income Credit
Të ardhurat Debi	-270.20	-259.00	-221.20	-314.70	-86.80	-111.70	-114.60	-90.30	Income Debt
Bilanci i transfertave	724.60	768.50	820.60	847.80	202.80	238.90	232.70	238.30	Balance of Transfers
Transferta private	851.80	921.50	961.20	961.90	224.40	260.50	253.90	264.10	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	-127.20	-153.00	-140.60	-114.10	-21.60	-21.60	-21.20	-25.80	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	86.70	125.70	66.30	122.40	18.30	21.20	22.90	41.60	Capital Account
Llogaria financiare	-956.30	-1,326.20	-712.60	-1,096.70	-146.90	-285.30	-171.90	-541.20	Financial Account
Investime direkte	-801.30	-823.00	-958.40	-972.60	-292.40	-222.60	-268.90	-242.10	Direct Investment
Investime portofoli	120.80	-324.80	204.60	-101.50	3.50	110.60	13.10	-202.30	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-275.80	-88.50	181.60	47.90	141.40	-173.40	83.40	-101.60	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	311.00	296.00	298.80	-230.10	-135.50	-44.90	107.50	54.70	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	50.80	259.50	48.00	185.90	-142.20	85.30	154.80	274.00	Overall Balance
	0.00	0.00		0.00					
Rezervat	97.20	609.60	47.60	185.40	-142.40	85.10	154.80	273.90	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	46.40	89.90	140.40	70.50	-0.60	-0.10	-0.50	-4.80	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2015	2016	2017	2018	2019			Millions of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Mjetet valutore neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2	406,573.1	412,974.7	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	407,654.7	418,562.1	417,605.4	436,487.8	428,969.2	431,419.9	437,560.5	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	41,991.5	28,949.4	26,917.8	24,043.3	24,812.0	24,846.7	24,585.7	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	63,394	65,915.7	59,998	21,779	24,331	23,987	28,805	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	48,752	34,255.6	18,407	-12,366	277	4,001	4,820	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	75,143.9	53,279.9	52,839.5	55,628.9	56,113.1	55,325.8	56,343.6	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	26,391.9	19,024.3	34,432.8	67,994.8	55,836.4	51,324.7	51,523.7	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera deponituese	12,237.0	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,648.9	1,725.7	1,720.0	1,827.2	1,847.0	1,878.3	1,940.4	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	383,972.8	414,380.9	452,243.1	423,427.9	413,895.1	412,381.9	423,488.7	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	451.8	194.0	146.6	80.6	81.3	85.2	85.7	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	34.2	47.2	96.8	285.4	246.0	96.1	110.1	Other accounts payable
Të tjera neto	-18,792	-20,953.6	-20,683	-20,659	-20,670	-20,836	-20,839	Other items net
Aksione	63,391.1	61,859.9	45,882.2	31,088.6	34,935.9	38,832.9	38,933.6	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019			Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Totali i kredisë	546,873	547,602.4	550,280.4	532,628.2	536,695.9	541,549.5	547,183.6	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	887.7	845.5	787.7	539.0	677.1	662.6	656.7	Credits to local Government
Në lekë	887.7	845.5	787.7	539.0	677.1	662.6	656.7	in Lek
Në valutë	-	-	0.0	0.0	-	0.0	0.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	27,419.7	26,863.9	29,515.4	20,270.1	20,810.7	19,834.9	21,416.8	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	22,326.1	23,993.9	24,453.5	16,594.2	16,799.0	15,785.0	16,830.4	in Lek
Në valutë	5,093.6	2,870.0	5,061.9	3,675.9	4,011.7	4,049.9	4,586.4	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	355,725.2	343,483.0	334,762.9	317,722.0	320,223.3	324,487.5	326,947.9	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	129,233.7	131,743.5	136,075.7	127,999.7	127,162.2	127,938.4	129,000	in Lek
Në valutë	226,491.5	211,739.5	198,687.2	189,722.3	193,061.1	196,549.1	197,947.9	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	9,537.7	8,687.6	7,944.6	10,164.0	10,234.3	10,433	11,102	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	5,036.2	4,242.3	3,522.3	4,802.1	4,738.4	4,893	5,418	in Lek
Në valute	4,501.5	4,445.3	4,422.3	5,361.9	5,495.9	5,539.9	5,684.0	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	153,303.1	167,722.4	177,269.8	183,933.1	184,750.5	186,131.9	187,060.0	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	83,319.7	98,722.3	108,419.1	118,744.1	119,297.6	119,772.1	120,859.6	in Lek
Në valutë	69,983.4	69,000.1	68,850.7	65,189.0	65,452.9	66,359.8	66,200.4	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 OFERTA E PARASË
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019			Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Baza monetare	383,972.8	414,380.9	425,243.1	423,427.9	413,895.1	412,381.9	423,488.7	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	15.3	7.9	2.6	-0.4	2.7	3.3	7.9	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	239,218.1	249,256.5	265,156.0	275,281.4	271,542.9	272,762.3	274,739.1	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	9.9	4.2	6.4	3.8	5.5	5.9	8.0	Y/Y change in %
Depozita	687,292.6	737,808	741,157	745,304	755,851.1	756,964.1	754,839.5	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	-29.7	7.3	0.5	0.6	2.0	2.7	3.6	Y/Y change in %
Agregati M1	384,106.9	435,432.3	461,550.1	478,717.6	481,254.7	483,695.2	487,490.3	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	8.7	13.4	6.0	3.7	6.5	6.6	9.9	Y/Y change in %
Agregati M2	723,975.7	736,944.1	738,900.0	731,352.3	732,038.2	733,256.7	735,593.2	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	0.2	1.9	0.3	-1.0	0.9	1.1	2.8	Y/Y change in %
Agregati M3	1,218,101.2	1,263,453.8	1,266,906.9	1,263,928.1	1,274,889.0	1,278,582.9	1,277,620.9	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	1.9	3.9	0.3	-0.2	1.3	2.1	3.2	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare								Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2	406,573.1	412,974.7	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	63,394.2	65,915.7	59,998.0	21,779.0	24,330.7	23,987.1	28,804.5	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	48,752.0	34,255.6	18,406.7	-12,365.8	276.7	4,001.1	4,819.9	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019			Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Në lekë	493,374	487,687	473,744	456,071	460,495	460,495	460,854	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	153,506	186,176	196,394	203,436	209,712	210,933	212,751	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	1,473.8	1,907.5	1,344.4	1,482.1	1,294.7	1,200.9	1,476.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	8,736.2	6,786.0	8,656.7	8,861.1	9,710.2	9,420.3	10,020.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,258.9	2,071.0	2,524.8	2,586.8	3,014.7	4,205.9	2,986.3	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	40,993.6	46,051.0	48,979.3	49,221.4	53,372.8	51,109.0	50,917.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	101,043.0	129,360.4	134,889.0	141,284.9	142,319.5	144,996.9	147,351.0	Other resident sectors
Depozita të tjera	339,869	301,512	277,350	252,635	250,783	249,562	248,103	Other deposits
Qeveria lokale	29.9	18.9	15.2	13.1	12.8	12.9	12.9	Local governments
Korporata jofinanciare publike	815.0	976.8	705.2	1,634.7	1,707.0	1,709.3	1,641.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	3,573.4	7,553.4	9,282.1	5,050.5	4,126.7	3,937.3	3,903.6	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,292.1	6,502.2	9,062.4	9,687.0	9,171.0	9,030.8	8,529.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	324,158.3	286,460.2	258,285.1	236,249.4	235,765.9	234,871.3	234,016.2	Other resident sectors
Në valutë	193,918	250,121	267,413	289,233	295,356	296,470	293,985	In foreign currency
Qeveria lokale	209.5	366.1	139.8	113.4	147.7	179.2	111.2	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,645.4	2,999.4	2,086.3	1,407.7	1,711.8	1,696.6	1,951.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,641.2	1,815.4	3,756.9	3,616.6	3,561.2	3,872.6	3,389.4	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	53,618.9	73,325.0	74,187.3	78,055.3	81,182.5	78,009.9	74,801.6	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	133,803.4	171,614.8	187,242.7	206,039.8	208,752.6	212,711.2	213,732.0	Other resident sectors
Totali	687,293	737,808	741,157	745,304	755,851	756,964	754,840	Total
Qeveria lokale	1,713.2	2,292.5	1,499.4	1,608.6	1,455.2	1,393.0	1,600.9	Local governments
Korporata jofinanciare publike	13,196.6	10,762.2	11,448.2	11,903.5	13,129.0	12,826.2	13,612.4	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,473.5	11,439.8	15,563.8	11,253.9	10,702.6	12,015.8	10,279.3	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	105,904.6	125,878.2	132,229.0	136,963.7	143,726.3	138,149.7	134,247.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	559,004.7	587,435.4	580,416.8	583,574.1	586,838.0	592,579.4	595,099.2	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019			Millions of Lek End of period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
AKTIVET	516,358	524,731	532,927	547,104	529,941	527,659	538,818	
Total	126,386	131,887	187,367	209,596	197,631	196,817	196,257	Total
Mbajtjet e SDR	30,578.8	27,211.8	25,725.3	19,625.0	20,028.7	20,136.8	20,082.1	SDR holdings
Arka në valutë	84.9	52.0	24.3	67.1	18.7	27.3	23.1	Foreign currency
Depozitat	95,722.4	104,622.9	161,617.3	189,904.2	177,584.0	176,652.6	176,151.8	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	323,679	315,113	259,538	261,577	266,052	268,535	276,156	Securities other than shares
Jorezident	270,453.6	261,877.5	206,818.9	205,990.4	209,990.6	213,275.2	219,896.0	nonresidents
Qeveria qendrore	53,225.5	53,235.2	52,718.8	55,586.8	56,061.0	55,259.3	56,259.7	central government
Huatë	14,641	31,660	41,591	34,145	24,054	19,985	23,983	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,654.0	1,725.9	1,719.8	1,827.1	1,846.5	1,876.8	1,938.4	Other resident secotrs
Derivatet financiare	27.7	15.8	11.7	19.3	43.6	19.5	22.7	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	32,741.6	25,094.1	23,844.9	21,224.9	21,648.6	21,649.0	21,744.8	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	18,882.5	20,961.2	20,574.7	20,542.0	20,512.4	20,654.7	20,655.4	Nonfinancial assets
DETYRIMET	516,358	524,731	532,927	547,104	529,941	527,659	538,818	LIABILITIES
Total	241,006	262,031	278,611	286,209	282,051	284,100	285,742	Total
Para në qarkullim	239,218.1	258,848.0	274,711.8	286,158.4	281,990.3	282,878.3	285,643.3	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	1,787.9	3,183.2	3,899.2	50.6	61.1	1,221.3	99.0	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	201,586	191,380	200,514	222,292	204,765	196,705	206,357	Deposits excluded from broad money
Jorezident	31,826.2	19,860.9	19,350.9	17,047.3	17,053.6	17,051.9	17,039.5	Nonresidents
Qeveria qendrore	26,340.8	18,975.1	34,384.3	67,945.2	55,786.6	51,285.7	51,485.8	Central government
Korporata të tjera depozituese	142,966.8	152,349.7	146,632.1	137,218.8	131,843.7	128,282.3	137,746.5	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	87.4	72.1	66.7	49.6	50.3	54.2	54.6	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	364.4	121.9	79.9	31.0	31.0	31.0	31.0	
Huatë	1,810	314	116	18	0	0	0	-
Jorezidentët	1,809.6	314.2	115.6	18.3	0.1	0.0	-	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	461.1	1,164.6	463.8	518.7	1,122.0	834.8	571.5	Other accounts payable
Alokimi i SDR	8,104.4	7,981.2	7,340.5	6,977.7	7,066.3	7,186.4	7,213.5	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	63,391.1	61,859.9	45,882.2	31,088.6	34,935.9	38,832.9	38,933.6	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania